



Si duhet vepruar në rast dhune në familje



A e njihni ju këtë??

Personi me të cilin ju jetoni – qoftë ky partner i lidhur në martesë, shok apo i afërm, është bërë i dhunshëm karshi jush, ose ju ka kërcënuar.

Bashkëjetesa në këtë mënyrë nuk është më e mundur.

Situata për ju është e lidhur me frikë dhe stres. Ju kërkoni një rrugëzgjdhje.

Këshillë dhe ndihmë

Ne ju informojmë dhe ju shoqërojmë, pavarësisht nëse ju dëshironi të ndaheni nga partneri apo të qëndroni tek ai.

Konsultorja e grave është një konsultore e pavarur për gratë. Ne ndërmjetësojmë edhe ndihmë për fëmijët e prekur nga dhuna. Këshillimi bëhet gratis dhe anonim. Ne jemi të lidhur me detyrimin për heshtje.

Në rast se ju nuk dini gjermanisht, atëherë lutuni të njohurëve apo shokëve që të telefonojnë tek ne. Me kënaqësi mund të vinë me vete në këshillim. Ne ndërmjetësojmë edhe përkthyes për gjuhë të ndryshme. - Fletë informative Edhe gratë refugjate me status qëndrimi të pasiguruar do të marrin nga ne gjithashtu këshillim dhe mbështetje sa më mirë që të jetë e mundur!

Në rast nevojë ne do të hartojmë me ju planin tuaj personal të sigurisë.

Mbrojtje dhe Siguri

Në rast se ju rriheni në shtëpi atëherë ju mund t'i telefononi numrit 110 të policisë, me qëllim për të marrë ndihmë të menjëhershme për shkak të keqtrajttimeve.

Policia ka mundësi, që të dëbojë autorin e veprës nga banesa. Burri duhet të japë çelësat dhe të largohet nga banesa. Deri në 14 ditë atij nuk i lejohet të kthehet përsëri mbrapsh.

Gjatë këtyre 14 ditëve ju keni mundësi, që të mendoni në qetësi, se ç'farë dëshironi të bëni.

Shfrytëzoheni këtë kohë për një bisedë këshillimi!

Ne ju mbështesin, në rast se ju dëshironi të bëni një kërkesë urgjente në gjykatë për caktimin e banesës së përbashkët. Veç kësaj ju mund të bëni kërkesë për një urdhër mbrojtjeje. Përmes këtij autorit të veprës nuk i lejohet që të kontaktojë me ju, që t'ju bezdisë juve, apo që të qëndrojë në afërsinë tuaj.

Në rast se lejëqëndrimi juaj është i varur nga bashkëshorti juaj, atëherë ju mund të bëni kërkesë për lejëqëndrimin tuaj. Ne ju ndihmojmë juve për verifikimin e statusit tuaj të qëndrimit dhe pretendimin tuaj për ndihma sociale.

Përmes ndarjes me burrin tuaj ju nuk e humbi të drejtën e përbashkët të kujdestarisë dhe nuk e humbni fëmijën tuaj. Për raste të caktuara ju mund të kërkoni të drejtën e kujdesatarisë që ta keni vetëm ju.

Shtëpia në mbrojtje të grave dhe fëmijëve

Ju duhet të vendosni, nëse pavarësisht nga këto mundësi ju do të keni nevojë për mbrojtjen nga ana e shtëpisë së grave.

Në rast nevojë ne ndërmjetësojmë edhe vende të lira në shtëpinë e grave për ju dhe fëmijët tuaj. Në shtëpinë e grave ju do të qetësoheni dhe do të planifikoni rrugën e mëtejshme të jetës suaj. Veç kësaj ju do të keni rregullisht biseda këshillimi.

Telefoni për ndihmë

Telefoni për ndihmë qëndron i hapur 24 orë për 365 ditë me rradhë në të gjithë vendin. Aty do të merrni në gjuhë të ndryshme informacione lidhur me mënyrën e sjelljen në rast dhune në familje. Numri hotline i telefonit pa pagesë: 08000-116016

Dhuna në familje është e dënueshme dhe JO OK!

Mbështetja në Filderraum



Frauen
helfen Frauen
Filder e.V.

Beratungsstelle Frauen helfen Frauen Filder e.V.

Nürtinger Str. 6 • 70794 Filderstadt

Fon: **0711-79 49 414**

e-mail: beratung@fhf-filder.de

www.frauenhelfenfrauenfilder.de